



SHQIP



ANGLISHT

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Fq. 2

Kryetarja e AMA-s vizitë në Departamentin Amerikan të Shtetit. Diskutohen sfidat aktuale të tregut mediatik shqiptar

Konferenca Globale e UNESCO-s, Krasniqi prezanton përvojën e bashkëpunimit të AMA-s me platformat TikTok dhe X. Nënshkruhet Deklarata e Pretorias



Fq. 2

DËRGO ANKESË PËR PLATFORMËN X




Fq. 3


Kreu i OSBE-së në Tiranë vizitë në AMA, diskutohen zhvillimet më të fundit në sektorin audioviziv dhe progresi i arritur për transparencën e pronësisë së medias

Monitorimi i përmbajtjeve, në janar u prodhuan më shumë lajme sociale

Muaji janar ka prodhuar më shumë lajme sociale për mediat audiovizive, ndryshe nga muaji dhjetor ku spikatën lajmet politike. Siç tregojnë të dhënat...



Fq. 2



Fq. 3

Mbyllet serveri i paligjshëm, pas raportimit nga AMA reagon menjëherë kompania ndërkombëtare Scaleway

Një server që transmetonte në mënyrë të paligjshme përmbajtje televizive dhe sportive është mbyllur pas një raportimi zyrtar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive. Sipas njoftimit, kompania ndërkombëtare Scaleway, me seli në Francë,...

Kryetarja e AMA-s vizitë në Departamentin Amerikan të Shtetit. Diskutohen sfidat aktuale të tregut mediatik shqiptar

Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, ka zhvilluar një vizitë dyditore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo u prit në Departamentin Amerikan të Shtetit nga zyrtari për Çështjet e Shqipërisë, Z. John W. Robbins, zyrtari për Diplomacinë Publike për Çështjet e Europës Qendrore, Z. Michael Marble, si dhe zyrtari për Iniciativat e Politikave Ndërkombëtare, Z. Evan Lord. Gjatë vizitës në SHBA, Kryetarja e AMA-s mori pjesë edhe në ceremoninë e zgjedhjes së presidentit të ri të "The National Press Club" (Klubi Kombëtar i Medias), që është organizata më e rëndësishme mediatike në SHBA. [Lexo më shumë](#)



Konferenca Globale e UNESCO-s, Krasniqi prezanton përvojën e bashkëpunimit të AMA-s me platformat TikTok dhe X. Nënshkruhet Deklarata e Pretorias


Rregullimi i platformave digjitale ishte thelbi i Konferencës Globale mbi Qeverisjen e Platformave Digjitale 2026, organizuar nga UNESCO në Pretoria, Afrika e Jugut. Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi, ndau përvojën e bashkëpunimit të AMA-s me platformat TikTok dhe X. Në përfundim të konferencës u miratua "Deklarata e Pretorias", një dokument strategjik që përmban angazhime konkrete për zbatimimin e Udhëzimeve të UNESCO-s dhe forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në mjedisin digjital. [Lexo më shumë](#)



Kreu i OSBE-së në Tiranë vizitë në AMA, diskutohen zhvillimet më të fundit në sektorin audioviziv dhe progresi i arritur për transparencën e pronësisë së medias


Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi, priti në një takim Kreun e Prezencës së OSBE-së në Tiranë, Ambasadorin Z. Michel Tarran, për të diskutuar mbi zhvillimet më të fundit në sektorin audioviziv dhe për të rikonfirmuar bashkëpunimin e ngushtë mes dy institucioneve. Z. Tarran vlerësoi punën e AMA-s, duke i cilësuar amendimet ligjore si një hap të rëndësishëm që rrit llogaridhënien dhe forcon pluralizmin dhe integritetin e sektorit mediatik. [Lexo më shumë](#)

Monitorimi i përmbajtjeve, në janar u prodhuan më shumë lajme sociale



Muaji janar ka prodhuar më shumë lajme sociale për mediat audiovizive, ndryshe nga muaji dhjetor ku spikatën lajmet politike. Siç tregojnë të dhënat e përlllogaritura nga ekipet e monitorimit dhe analizës në AMA, pas lajmeve sociale me 19.45%, vijnë lajmet politike me 15.29%, të ndjekura nga lajmet ndërkombëtare me 14.93%.

[Lexo më shumë](#)



Mbyllet serveri i paligjshëm, pas raportimit nga AMA reagon menjëherë kompania ndërkombëtare Scaleway

Një server që transmetonte në mënyrë të paligjshme përmbajtje televizive dhe sportive është mbyllur pas një raportimi zyrtar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive. Sipas njoftimit, kompania ndërkombëtare Scaleway, me seli në Francë, ka reaguar menjëherë, duke mbyllur serverin që shpërndante përmbajtje audiovizive pa autorizim. Autoriteti i Mediave Audiovizive thekson se do të vijojë monitorimin dhe raportimin e çdo rasti të shkeljes së ligjit, në mbrojtje të transmetuesve ligjorë dhe të interesit publik.

[Lexo më shumë](#)